



I nderuari z. Oberhuber,

I nderuari z. Dinkelborg

I nderuari z. Aliu,

I nderuari z. Engels,

I nderuari z. Elsen.

Të nderuar përfaqësues të bankave qendrore të rajonit

Të nderuar përfaqësues të bankave komerciale në Kosovë

Të nderuar të pranishëm

Mirë se vini në Prevallë, Kosovë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në punëtorinë Ballkani Perëndimor: Reformat rregullatorë bankare dhe zbatimimi i tyre – sfidat përpara, të organizuar bashkërisht nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe GIZ-i Gjerman. Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj edhe bankën ProCredit dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës për përkrahjen e tyre në organizimin e kësaj punëtorie.

Kjo punëtori sigurisht se nuk do të kishte kuptim pa mbështetjen shumë të rëndësishme që kemi pranuar nga përfaqësuesit e Single Resolution Board, Deutsche Bundesbank, BaFin, BQE dhe Banka e Sllovenisë të cilët me pranimin e ftesës për të diskutuar në këtë punëtori kanë shprehur edhe një herë përkushtimin e tyre për t'i ndihmuar vendet e rajonit tonë në konvergjinë se më të lehtë drejtë standardeve të tyre. Po ashtu, dëshiroj të falënderoj shumë pjesëmarrësit nga bankat qendrore të rajonit, si dhe përfaqësuesit nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë për pjesëmarrjen dhe për kontributin e rëndësishëm që ata pritët t'i japin kësaj punëtorie.

Duke pasur parasysh dinamikën me të cilën po zhvillohet industria financiare dhe rëndësinë çdo ditë e më të madhe të stabilitetit financiar për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të çdo vendi,

BQK-ja ashtu edhe si bankat tjera qendrore të rajonit, me kohë ka vendosur si prioritet shumë të rëndësishëm zbatimin e vazhdueshëm të standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e rregullativës financiare.

Dinamika me të cilën po zhvillohet rregullativa financiare ndërkombëtare kërkon resurse të konsiderueshme për t'u zbatuar nga bankat qendrore dhe kjo sigurisht se paraqet një sfidë të rëndësishme për bankat qendrore më të vogla, siç janë BQK-ja dhe bankat tjera të rajonit tonë. Sidoqoftë, përmes organizimeve të tilla ne do të jemi në gjendje që t'i bashkojmë energjitë dhe përvojat në mënyrë që të jemi sa më efektiv në ndjekjen dhe zbatimin e standardeve më të mira ndërkombëtare.

Prandaj, kjo punëtori është dizajnuar në mënyrë të tillë që të kemi prezent partnerët tanë që vijnë nga institucione me të arritura të rëndësishme në këtë fushë për të na informuar dhe për të na sqaruar rreth zhvillimeve të fundit të kërkesave rregullatore dhe gjithashtu për ta na ndihmuar të kuptojmë më mirë se çfarë qëndron para nesh.

Për një sistem bankar të ri si Kosova, sigurisht që zbatimi i kërkesave të Basel III, IFRS 9 dhe zbatimi i procedurave të rregullta për likuidimin e bankave (Bank Resolution) ka qenë dhe është mjaft sfidues. Megjithatë, me përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtar kemi arritur progres të konsiderueshëm dhe sot rregullativa jonë financiare po arrin të mbështetë zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar të vendit.

Sektori bankar i Kosovës mbetet një ndër sektorët më të suksesshëm dhe me trend të vazhdueshëm të rritjes. Edhe gjatë vitit 2018 sektori bankar vazhdoi të tregoj qëndrueshmëri të komponentëve përbërës të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Sipas të dhënave të fundit të muajit qershor 2018, vlera e gjithsej mjeteve të sektorit bankar arriti në 3.9 miliardë euro, derisa struktura e mjeteve vazhdoi të finanohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredidhënies.

Vlera e përgjithshme e kredive të sektorit bankar në qershor 2018 ishte rreth 2.7 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.3%. Treguesi i kredive joperformuese u zvogëluar në 2.8% në

fund të muajit qershor nga 3.9% sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjë që tregon për një afarizëm mjaft të shëndoshë të bankave që operojnë në vendin tonë. Gjithsej depozitat evidentojnë rreth 3.1 miliardë euro, ndërsa gjendja e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë e qëndrueshme. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve me afat të mbetur deri në një vit përlllogaritet 33.2%, i cili evidentohet lartë mbi kërkesën rregullative prej 25.0%.

Spektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar. Treguesi i kapitalit të bazuar në rrezik në muajin qershor 2018 ishte 17.4%, që është lartë mbi kërkesën rregullative të BQK-së prej 12.0%.

Kjo fotografi e shkurtër tregon se sektori bankar i Kosovës po kalon nëpër një periudhë të kënaqshme dhe është në përputhje me kërkesat rregullative. Në përgjithësi, një situatë e kënaqshme po karakterizon edhe sektorët bankarë të bankave të tjera të rajonit. Prandaj, konsideroj se jemi në një kohë të përshtatshme për të mbledhur forcat dhe për të punuar edhe më intenzivisht në avancimin e kapaciteteve tona.

Rrjedhimisht, mendoj se kjo është një mundësi e mirë për të gjithë përfaqësuesit nga bankat qendrore të Ballkanit Perëndimor që të shfrytëzojnë prezantimet dhe panelet e dedikuara për të kuptuar sa më mirë zhvillimet që po ndodhin në rregullativën financiare dhe për të shfrytëzuar rastin të marrin udhëzime konkrete nga folësit tanë të nderuar për hapat e ardhshëm. Prezenca e përfaqësuesve të bankave komerciale konsideroj se do ta pasuroj diskutimin në këtë punëtori dhe do të na mundësojë të kemi një pikurë më të qartë për çështjet që do të diskutohet këtu.

Unë shpresoj që fryma e shkëlqyeshme e bashkëpunimit ndërmjet bankave qendrore të rajonit, partnerëve tanë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe industrisë financiare të vazhdojë të rritet edhe më tutje dhe uroj që kjo punëtori të japë kontribut të rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit mes nesh.

Në fund, unë ju uroj të gjithëve diskutime të frytshme, të suksesshme dhe interesante në këtë punëtori, si dhe ju uroj qëndrim të këndshëm në Malet e Sharrit.